

community

The New Apostolic Church around the world

04/2019/AI



Shërbesa e Pentakostit 2019

**Editoriali: Me gjithe forcën,
fuqinë**

**Shërbesa fetare: Si vepron
Shpirti i Shenjtë**

Doktrina: Rikthimi i Krishtit

New Apostolic Church
International



■ Editoriali

3 Me gjithë forcën, fuqinë

■ Shërbesa fetare

4 Veprimi i Shpirtit të Shenjtë

■ Këndi i fëmijëve

10 Për vizitë te Rúben në
Maranguape (Brazil)

■ Doktrina

12 Rikthimi i Krishtit

■ Pjesa rajonale

16 Përjetime

Me gjithë forcën, fuqinë

Të dashur motra e vëllezër të besimit,

Shpirti i Shenjtë vepron me forcë të madhe – kështu ishte edhe atëhere, kështu është sot e kështu do të jetë edhe nesër. Shpirti i Shenjtë na këshillon, na forcon, na ngushëllon dhe na frymëzon. Ai është shoqëruesi i vazhdueshëm në cdo situatë të jetës.

Ne e dallojmë Shpirtin e Shenjtë ne veprimin, në efektin e tij:

Në Kishën e Krishtit ai forcon prej vitesh besimin në Jezusin – edhe kur përndiqesh, kur vuan apo je në nevojë. Dhe ai pret prej nesh, si atëhere edhe sot, që të çojmë më tutje Ungjillin, duke qenë të sigurt se: Jezu Krishti është Biri i Perëndisë.

Nëpërmjet apostulatit Shpirti i Shenjtë përgatit besimtarët për rikthimin e Jezusit. Po kështu nëpërmjet apostulatit besimtarët marrin dhunitë e Shpirtit të Shenjtë dhe së bashku ata festojnë Darkën e Shenjtë.

Shpirti i Shenjtë vepron edhe në bashkësi – si në ato të voglat, ashtu edhe në të mëdhatë, pavarësisht nga rrethanat e jetësës dhe të kulturës; ai është prezent.

Shpirti i Shenjtë u jep besimtarëve forcën për t'i qëndruar besnik Jezu Krishtit dhe për të pasë besim të fortë tek ai. Shpirti i Shenjtë dhuron forcë për të mbajtur peshën e rëndë, dhe për t'i shërbyer tjetrit në bashkësi.



Foto: NAC International

Asgjë nuk mund ta ndalojë Shpirtin e Shenjtë. Asgjë nuk mund ta ndalojë zhvillimin e mbretërisë së Perëndisë. Shpirti i Shenjtë vepron, punon me forcë të madhe. Me forcë duhet që edhe ne ta bëjmë të dukshme këtë forcë e fuqi si nëpër bashkësi ashtu edhe për veten tonë.

Falenderojmë Zotin, Shpirtin e Shenjtë, tanë e vazhdimesht, për veprimin e tij në Kishën e Krishtit, për postin e apostujve, për bashkësitë dhe për secilin prej nesh.

Të fala të përzemërtë,

Juaji Jean-Luc Schneider

Veprimi i Shpirtit të Shenjtë



Motrat e vellezërit e rreth 100 shteteve në të gjitha kontinentet
ndoqën shërbesën fetare nga Goslar (Gjermani)

Photo: Oliver Rütten



1. Korint12,13

*Sepse të gjithë ne jemi pagëzuar në
një Frymë të vetëm në të njëjtin trup,
qofshin hebrenjtë apo grekët, qofshin
skllevërit a të liruarit, dhe të gjithë jemi
ujitur me të njëjtën Frymë.*

Po, të dashur motra, të dashur vellezër, në Penrtakost neve kujtojmë derdhjen, ardhjen e Shpirtit të Shenjtë, krijimin e Kishës së Krishtit, dhe sigurisht që kjo është një arsy për të gjëzuar. Për ne është një rast i bukur për të lëvduar e nderuar, Perëndinë, Shpirtin e Shenjtë. E di se duket ndonjëherë disi abstrakte. Për Zotitn, At, ka njeriu një imaginatë. Mund ta imagjinosh mirë krijuesin e gjithshkaje. E shikojmë krijimin e tij. Me Perëndinë At ne lidhin atë kujdes atëror. Për Birin e Perëndisë njeriu kujton menjëherë Jezu Krishtin. Edhe këtu mund të imagjinojmë shumë gjëra. Por për Shpirtin e Shenjtë, për fuqinë dhe forcën e Zotit, kjo tingëllon disi pak më abstrakte. Por nuk mund të perceptosh, të krijosh një tabllo të Shpirtit, të Frymës së Shenjtë, atë vetëm mund ta përjetosh dhe ta dallosh nëpërmjet asaj që ai bën me njerëzit dhe nëpërmjet

tyre. Njeriu e dallon Shpirtin e Shenjtë nëpërmjet veprimit të tij. Atëhere ai bëhet menjëherë konkret.

Që nga krijimi i Kishës së Krishtit ai vepron me forcë në Kishën e tij. Ai nuk ka pushuar kurrë së punuari në Kishën e Krishtit. Që nga koha kur Fryma e Shenjtë vepron, dhe punon në tokë, ajo u ka dhënë shumë njerëzve njohurinë, se Jezu Krishti është Biri i Zotit. Pali thotë, se pa veprimin e Shpirtit të Shenjtë njeriu nuk mund të dallojë apo të dijë, se Jezu Krishti është Biri i Zotit. Nëse një njeri fiton njohurinë, dituri, se Jezu Krishti është Biri i Zotit, ky është vetëm një veprim apo një efekt i Shpirtit të Shenjtë. Gjatë gjithë kësaj kohe Shpirti i Shenjtë është kujdesur, që njerëz besimtarë, të cilët janë afruar tek Jezu Krishti, të bëhen anëtarë të kishës së tij nëpërmjet pagëzimit në kishë. Shpirti i Shenjtë është kujdesur, që mesazhi i Ungjillit të çohet më tutje deri në skajin e fundit të botës. Ai është kujdesur që besimtarët të forcojnë besimin e tyre nëpërmjet predikimit të Ungjillit. Le të kujtojmë e mendojmë se çfarë kanë përjetuar e duruar të krishterët në këto shekuj. Disa u përndoqën, të tjerë kanë përjetuar vuajtje e mundime, dhe Shpirti i Shenjtë është kujdesur që ata të ngrihen dhe të qëndrojnë të fortë në besimin ndaj Jezu Krishtit. Në të gjithë historinë e krishtërimit ka pasur

shumë të krishterë, të cilët kanë përjetuar më të keqen. Të gjithë kanë thënë, e po ku është ky zot tanë? Dhe të forcuar e fuqizuar nga predikimi i Ungjillit ata kanë qëndruar të fortë në besimin: Jo, unë besoj në Jezu Krishtin, unë do ta ndjek atë. Këtu mund të dallosh mirë atë veprim të fuqishëm të Frymës së Shenjtë. Shpirti i Shenjtë vepron në Kishën e Krishtit. Natyrisht që në anën e dukshme të kishës së Krishtit kanë ndodhur shumë gjëra, të cilat nuk kanë qenë të mira, pasi njerëzit janë dhe do të mbetet njerëz. Ndjonjëherë është keqtrajtuar edhe emri i Jezu Krishtit për qëllime lufte. Të krishterët kanë përndjekur dhe kanë vrarë edhe jo të krishterë. Edhe ndërmjet tyre kanë luftuar e kanë vrarë. Shumë gjëra të këqija e shumë gabime të mëdha janë bërë. Thjesht, sepse njerëzit

janë thjesht njerëz. Porse Shpirti i Shenjtë është kujdesur, që pavarësisht nga këto gabime e papërsosmëri njerëzore, Ungjilli të përhapej më tej dhe të krishterët të vazhdojnë të besojnë në Jezu Krishtin dhe t'i qëndrojnë besnik atij. Kur mendon gjatë e kupton sesa me forcë punon Shpirti i Shenjtë, sa që me gjithë këto të meta e gabime, që janë bërë, besimi i krishterë nuk ka vdekur. Ka shumë të krishterë që janë besimtarë dhe e ndjekin Krishtin. Ne e falenderojmë Shpirtin e Shenjtë, se ai ka punuar me forcë të madhe ne të gjithë këta shekuj dhe vazhdon të punojë akoma.

Në bashkësi është ndezur zjarri i Shpirtit të Shenjtë

djathtas: Mbas leximit të fjalës së marrë nga Bibla vazhdon leximi i biblës nga Vep e Apost 2,36-43

poshtë: Takim i përzemërt tek kisha në Goslar (Gjermani)





E falenderojmë Shpirtin e Shenjtë, pasi vepron nëpërmjet apostujve. Që nga koha kur posti i apostujve u rizu me njerëz, Shpirti i Shenjtë vepron më me forcë nëpërmjet tyre. Nëpërmjet apostujve njerëzit mund të marrin dhunitë e këtij Shpirti dhe mund të bëhen një krijesë e re në Jezu Krishtin. Veprimi i Shpirtit të Shenjtë e bën të mundur, që ne të festojmë marrjen e Darkës së Shenjtë dhe në këtë mënyrë të mund të shijojnë trupin dhe gjakun e Jezusit. Ky Shpirt vepron me forcë nëpërmjet apostujve dhe thotë: Zoti do të vijë së shpejti! Por pasi posti i apostujve u mbush përsëri, pati shumë sfida dhe vështirësi. Aty-këtu apostujt dhe pasuesit e tyre, siç ju thoshin, janë përndjekur. Por Shpirti i shenjtë ka vepruar edhe më tej. Askush nuk mund ta ndalte atë. Edhe apostujt janë thjesht njerëz, pra jo të përsosur. Edhe atje ku veprojnë apostujt bëhen gabime. Edhe atje mund të ndodhë, që mendimet njerëzore dhe pikëpamjet kulturore përzihen disi në një

predikim, dhe mund të predikohen gjëra, ku mund të thuash epo mirë, por kjo nuk ka të bëjë fare me Ungjillin. Edhe apostujt janë thjesht njerëz, të cilët absolutisht nuk janë të përsosur. Por kjo papërshtatshmëri njerëzore nuk

e ka penguar kurrë Shpirtin e Shenjtë. Ai vepron fuqishëm nëpërmjet apostujve. Dhe dhunitë e Shpirtit të shenjtë do të dhurohen, darka e Shenjtë do të jetet dhe bashkësia nuse do të përgatitet. Ne

i jemi mirënjoës Shpirtit të Shenjtë, që ai akoma vepron fuqishëm nëpërmjet apostujve dhe që bashkësia nuse mund të përgatitet.

Ne falenderojmë Shpirtin e Shenjtë, pasi ka vepruar kaq fuqishëm në gjithë këta shekuj.

Shpirti i Shenjtë vepron fuqishëm në Kishën e Krishtit. Ai vepron fuqishëm nëpërmjet postit të apostujve. Ai vepron fuqishëm nëpër bashkësi dhe ndërmjet fëmijëve të Zotit. Ne kemi ndërkohë rreth 60.000 bashkësi. Në këto bashkësi është i ndezur zjarri i Shpirtit të Shenjtë. Kujtoj këtu në



fillim tē rintjtē. Ju sigurisht e kuptioni që unë edhe një herë do tē përmend shërbesën e e fundjavës së fundit. Të gjithë ata, tē cilët përjetuan atë takim madhështor tē tē rinvje në Düsseldorf, mund ta dëshmojnë, se atje rrinte ndezur zjarri i Shpirtit të Shenjtë! Ajo rini qe entuziaste pér Jezu Krishtin, e ndjek pas atë dhe i shërben atij. Këtë nuk e kam përjetuar vetëm në Düsseldorf, këtë e përjetoj çdo herë që jam në botë me tē rintjtë tanë. Kjo me siguri që ja vlen ta falenderosh Zotin që na ka dhënë kaq shumë tē rinj, tē cilët janë ndezur pér Jezu Krishtin, dhe e lenë veten tē mësohen dhe drejtohen nga Shpirti i Shenjtë. Por kjo nuk na ndodh

vetëm me tē rintjtë. Unë mund tē them se kështu është edhe nëpër 60.000 bashkësitë në tē gjithë botën. Edhe në ato bashkësitë krejtësisht tē vogla, ku mblidhen vetëm një dorë njerëz, Shpirti i Shenjtë vepron me fuqi. Nuk ndodh kështu që tē thuash, ah jemi vetëm tre apo jemi vetëm pesë veta – aty është i ndezur zjarri i Shpirtit të Shenjtë me flakë tē vogla. Edhe në këto bashkësi kaq tē vogla shpaloset Shpirti i Shenjtë me forcën e fuqinë e tij dhe besimtarët mund tē përjetojnë prezencën e Perëndisë! Ata mund tē marrin plotësisht shpëtimin. Shpirti i Shenjtë nuk vepron vetëm pér një shifër, pér një numër tē caktuar. Ai mund



Darkën e Shenjtë për shpirrat e larguar nga kjo jetë e marrin si përfaqësues apostuli i distriktit Peter Schulte (Pacificu Perëndimor) dhe apostuli Helge Mutschler (Gjermania e Veriut dhe e Lindjes)

Apostuli i distriktit Rüdiger Krause (Gjermania e Veriut dhe e Lindjes) hap kupat e hostjeve për Darkën e Shenjtë



të veprojë me fuqinë e tij edhe në një bashkësi krejtësisht të vogël, edhe në situata krejtësisht të pamundura. Unë mendoj për ato shumë bashkësi, për motrat e vëllezër që janë mbledhur sëbashku në kampet e refugjatëve. Të tjerëve iu duhet të fshihen, e të mblidhen sëbashku nëpër pyje të dendur. Nuk kanë asgjë, porse marrin shpëtimin shpirtëror nëpërmjet forcës së Shpirtit të Shenjtë. Në vendet, ku ne kemi shumë anëtarë, kemi edhe bashkësi, të cilat ndodhen nëpër burgje. Janë akuzuar si të krishterë apostolikë dhe janë dënuar. Edhe atje mbahen shërbesa fetare. Shoqëria u ka thënë: Nuk ju duam, ju duhet të largoheni nga rruga. Por atje ku ndahet Darka e Shenjtë, atje mund të veprojë me forcë e fuqi Shpirti i Shenjtë. Edhe këto motra e vëllezër, këta besimtarë në këto kushte të veçanta e përjetojnë prezencën, praninë e Perëndisë, e përjetojnë mëshirën e tij dhe marrin gjithshka, që iu duhet për shpëtimin e tyre. Këto janë tanë disa shembuj konkretë. Ne e falenderojmë Shpirtin e Shenjtë, i cili punon me kaq forcë e fuqi në çdo bashkësi edhe pse nëpërmjet njerëzve të papërsosur.

Fryma e Shenjtë është e fortë dhe funksionon fuqishëm në vëllezër dhe motrat tanë. Kemi kaq shumë vëllezër dhe motra që janë një model për ne. Ata kanë vite që mbartin

një ngarkesë të madhe. Ata po përjetojnë mjerim të madh, vuajtje të tmerrshme. Ndonjëherë pyesim veten: Si e bëjnë atë? Si e përbaloni këtë? Këta vëllezër dhe motra kanë një besim te Zoti, besim të palëkundshëm në Zot. Ata vazhdojnë ta duan dhe ndjekin Jezu Krishtin dhe mbesin besnikë. Ju vetëm mund të mrekulloheni dhe admironi ato. Unë mendoj për këta shumë vëllezër dhe motra që i shërbijnë Zotit në mënyrë të paprekshme, qoftë në zyrë apo në ministri. Ju keni 250 arsyë për të thënë që nuk jam më pjesë e saj. Ata thjesht vazhdojnë të shërbijnë sepse e lënë veten të udhëhiqet dhe drejtobet nga Fryma e Shenjtë. Falënderojmë Zotin, Frymën e Shenjtë, për gjithë forcimin, ngushëllimin dhe ngrëjtjen morale të këtyre vëllezërve dhe motrave. Unë do të doja të them një mesazh të veçantë për këtë Pentakost dhe të jetë goja që flet apostolati në të gjithë botën dhe t'ju them, të dashur vëllezër dhe motra kudo ku jeni: Ne si apostuj të Jezu Krishtit, mund të themi si Pali: Falënderojmë Zotin për gëzimin që përjetojmë përmes jush! Ju jeni gëzimi ynë! Unë do të doja të shpreh falënderimet e mia në emër të të gjithë Apostujve. Përsëri, themi si Pali: Falënderojmë Zotin për gëzimin që mund të përjetojmë përmes jush! Ju jeni gëzimi ynë! Doja ta thoja këtë.



Ndihmës apostuli i distriktit David Devaraj (Indi)



Apostuli i distriktit Kububa Soko (Zambia, Malawi, Simbabwe)



Ndihmës apostuli i distriktit John W. Fendt (USA)

Ky veprim i fuqishëm i Frymës së Shenjtë në Kishën e Krishtit, përmes apostulatit, në kisha, në vëllezër dhe motra, është për ne një burim ngushëllimi dhe gëzimi. Ky është kyçi dhe themeli i shpresës sonë. Fryma e Shenjtë do të jetë e fuqishme deri në fund. Zoti Jezus dikur foli për mbretërinë e Perëndisë dhe e krahasoi atë me një farë, që një njeri e hedh, e vendos në tokë. Ai tha nëse njeriu është duke zgjuar ose duke fjetur, apo nëse po punon ose jo: fara vazhdon të rritet dhe ai nuk e di se si. Jezusi dëshironte të thoshte se zhvillimin e mbretërisë së Perëndisë nuk mund ta ndalojnë dot njerëzit, kjo është në një mënyrë misterioze në vazhdimin e saj. Fryma e Shenjtë do të vazhdojë të punojë me forcë mbi ne. Kur e lëmë veten të jemi të drejtohem i dëshiruar. Ai përfundon kriesën e re tek ne, dhe ne njerëzit e papërsosur mund të bëhem i imazhi i Jezu Krishtit. Fryma e Shenjtë do të vazhdojë të punojë me forcë përmes apostulatit dhe do t'i ndihmojë apostujt në përmbrushjen e misionit të tyre deri në fund. Nusja e Zotit do të përgatitet kur të vijë Zoti. Fryma e Shenjtë do të vazhdojë të jetë e fuqishme në Kishën e Krishtit, edhe pas Ardhjes përsëri të Jezu Krishtit. Ai do ta kuptojë që të krishterët besimtarë ushqehen nga Fryma e Shenjtë. Gjithashtu gjatë shtrëngimeve antikrishtërore, këto vuajtje do të janë të mëdha. Nëse armiku i Jezu Krishtit vë në rrezik gjithçka, ai nuk mund të ndalojë punën e Frymës së Shenjtë. Fryma e Shenjtë do të sigurojë që të krishterët të vazhdojnë të ushqehen dhe të qëndrojnë besnikë ndaj Zotit Jezu Krisht. Fryma e Shenjtë do të përfundojë punën e tij. Ai do të përfundojë Kishën e Krishtit dhe do t'i udhëheqë

ata në krijimin e ri, ku ata do të kenë bashkësi të përjetshme me Perëndinë. Kur e shihni këtë, të dashur vëllezër, kemi shumë arsyë për të falënderuar, lavdëruar dhe lavdëruar Shpirtin e Shenjtë, Zotin dhe Frymën e Shenjtë. Kemi kaq shumë arsyë për ta falënderuar Atë që na bëri aq të pasur me Jezu Krishtin. Edhe ne, apostujt, kemi kaq shumë arsyë për të falënderuar që na bënë aq të pasur me Jezu Krishtin. Me të vërtetë, lavdi Zotit dhe Frymës së Shenjtë. Ai do të përfundojë punën e tij. Amin.

MENDIME KYÇE

Ne e dallojmë forcën e Perëndisë, Shpirtin e Shenjtë, në historinë e Kishës, në shërbimin e apostujve dhe në atë të besimtarëve.

Ne duam të jetojmë prej Shpirtit të Shenjtë! Pastaj duam të zgjohemi nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë në ditën e ardhjes së Krishtit.

PËR VIZITË TEK RÚBEN NË MARANGUAPE (BRAZIL)

Përshëndetje, unë jam Rúben – mire se erdhet në atdheun tim, Brazilin!

Brazili është vendi më i madh i Amerikës së Jugut dhe i pesti në botë përsa i përket madhësisë. Unë banoj pranë Fortalezës, kryeqyteti i Landit Ceará, pikërisht në Brazilin e Veriut. Këtu është shumë nxehtë gjatë gjithë vitit.


Plazhet tona janë shumë të bukura. Turistë të shumtë vijnë në Fortaleza për të shijuar detin dhe plazhet.



Në plazhe dhe në det shikon Jangadase të shumtë. Ato janë të ndërtuara si një kurri peshku prej druri, ku peshkatari të shumte hyjnë e dalin me varkat e tyre për të zënë peshq të medhenj.

Qyteti ku unë banoj quhet Maranguape. Eshtë i rrethuar me male e me det; zona jonë është e gjelbërt dhe e bukur. Mua më pëlqen shumë të shetis me babain dhe motrën nëpër natyrë. Para dy muajve mbusha gjashtë vjeç. Kur të rritem dua të eci neper rrugët e ngushta dhe të zbuloj sa më shumë kafshë, të cilat gjenden vetëm këtu.

Unë kam dy motra, Rutin dhe Rakelën, ato janë binjake. Unë i dua shumë ato dhe ato më duan mua. Këtu kemi dalë përpëra kishës sonë në Maranguape. Të dyja këndojnë në korrin e distriktit. Edhe unë dua të këndo më vonë në këtë korr. Këngët që këndo-hën atje më pëlqejnë shumë. Megjithëse nuk i kuptoj dot të



gjitha ato që predikohen, unë e di se çdo shërbesë fetare është e veçantë. Babai më thotë, se ne e takojmë Atin tonë qillor në çdo shërbesë fetare.

Dhe kështu duket kisha nga brenda. Babai im është evangjelist distrikti. Gjatë javës pasi dal nga shkolla ai më merr mua me vete nëpër bashkësitë e tjera. Më shumë më pëlqen Mucunã. Atje ka një kopësht të bukur, për të cilin kujdesen motrat e bashkësisë.

Kjo është familja ime, sa po kisha lindur unë. Nëna ime u sëmur dhe u ngjit lart në përjetësi, kur unë isha katër vjeç. Mua më mungon shumë ajo. Babai më thotë se mama ja më ka dashur shumë. Mbas dy vajzave ka uruar të ketë edhe një djali dhe kështu linda unë. Zoti ynë i dashur ja plotësoi dëshirën asaj.



Gjatë ditës jam në shkollë. Në mëngjes bëj detyrat atje, të cilat i kam marrë një ditë më parë. Shokët e mi atje quhen Heitor, Vinícius, Emanuela dhe Sofia. A e dinit ju se tek ne notat janë prej 0 deri në 10? 10 është nota më mirë. Viti mësimor fillon në shkurt dhe mbaron në fillim të dhjetorit. Në korrik kemi dy javë



Më pas unë kam kohë të luaj me figura aksioni. Këtu po mbaj figurën më të dashur timen, Max Steel.

Mbi motorr dukem edhe unë gati si një hero aksioni, apo jo?





Photo: © iCreations.de - stock.adobe.com

| Rikthimi i Krishtit

Detyra e apostulatit, siç e bën të qartë edhe apostuli kryesor Jean-Luc Schneider, në shkrimin e tij drejtuar bashkësive është – të përgatisë të krishterët për rikthimin, për ardhjen e Krishtit, për t'i bërë ata të fortë ndaj kërkeseve të shekullit 21.

Të krishterët besojnë se, Shpirti i Shenjtë është prezent dhe vepron në Kishë (Katekizmi i Kishës Apostolike të re (KNK-FA) 712). Ne e njohim, e dallojmë efektin apo veprimin e këtij Shpirti në kishë, pasi

- premtimi i ardhjes përsëri të Jezu Krishtit mbahet, ruhet gjallë (KNK-FA 203).
- Apostujt, të mbushur prej Shpirtit të Shenjtë, punojnë për të përgatitur besimtarët për rikthimin e Jezu Krishtit (KNK-FA 433).
- predikimi i inspiruar nga Shpirti ka për qëllim për t'i drejtuar bashkësitetë drejt ardhjes së Jezu Krishtit (KNK-FA 626).

Katekizmi nxjerr në pah, „se varet nga qenia, nga natyra e apostulatit për të shpallur ardhjen e Krishtit dhe për të përgatitur bashkësitetë për këtë“ (KNK-FA 442). Më duket e drejtë, që pyesim veten, se cila është mënyra më e mirë për të shpallur rikthimin e Krishtit dhe për të mbajtur zgjuar në kohën e sotme këtë premtim.

Shkaqet e pengesave në shpalljen e rikthimit të Zotit

Të krishterët e parë qenë të bindur për një ardhje të shpejtë të Krishtit, e cila shtrihej para tyre. Por mos realizimi apo mos përbushja e premtimit, së bashku me ndërprerjen e punës së apostujve, i çoi të krishterët deri atje, sa ta shtynin rikthimin e Zotit në një të ardhme gjithnjë e më të largët.

Rikthimi i afërt i Zotit shpallet më me autoritet që nga koha e rizënies përsëri me njerëz e postit të apostujve. E megjithëatë ne konstatojmë, se premtimi për ardhjen përsëri të Jezu Krishtit nuk shkakton atë entuziazëm që meriton. Shkaqet e kësaj janë të shumta. Më poshtë po përmendim disa:

- Apostujt e shpallin ardhjen përsëri të Jezusit që prej viteve tridhjetë të shek 19, e megjithatë ajo nuk ka ndodhur akoma. Ato shenja, të cilat ishin pritur se do të shfaqeshin pikërisht në kohën e fundit, i lanë vend interpretimeve të ndryshme, të cilat shpesh u vërtetuan si të gabuara.
- Për shkak të faktit, se në shumë vende janë përmirësuar kushtet e jetesës, besimtarët pikërisht atje nuk e ndjejnë të nevojshme që t'i „largohen“, jetës në këtë tokë, apo për të „shpëtuar“ nga kjo botë. Shumë, qofshin këta edhe ndër të lartpërmendurit, bazohen më tepër tek zhvillimet sociale dhe ekonomike, tek Perëndia, për të përmirësuar ekzistencën e tyre.
- Karakteri mbinatyror i ngjarjeve, që ne shpallim (Rikthimi i Krishtit, Ringjallja e të vdekurve, ngjit

e të gjallëve, mbretëria mijëvjeçare e paqes), e bën predikimin tonë për një pjesë të bashkëkohësve tanë shumë të vështirë për t'u kuptuar. Edhe në mesin e radhëve tona mendohen mirë disa nga mësuesit tanë, që të mos i diskutojnë këto gjëra me fëmijët, me qëllim që të mos i traumatizojnë ata.

- disa nuk pajtohen me mendimin, se Jezusi kur të vijë do të zhvillojë një gjygi. Fakti se do të gjykohen prej Zotit është për ta i frikshëm dhe nuk përpunhet më imazhin që ata kanë për Jezusin. Të mos harrojmë këtu, se shumë prej besimtarëve kanë familje, të cilat përbëhen nga apostolikë të rinj dhe nga të tjerë që nuk janë të tillë, ose anëtarë që e praktikojnë dhe të tjerë që nuk e praktikojnë besimin e tyre. Mendimi se me ardhjen e Jezusit mund të jenë të ndarë nga njëri-tjetri, shkaktojnë midis motrave e vëllezërve të tillë siklet dhe vuajtje.
- Doktrina jonë rrëth gjëra të së ardhmes nuk përpunhet krejtësisht me atë të shumë besimeve të tjera. Kur ne flasim për rikthimin e Jezu Krishtit, kështu na thonë, theksohen shumë më tepër dallime se sa ngjashmëri me të krishterët e tjerë. Dhe kur mësojmë se dikush duhet të vuloset nga një apostull i gjallë, që t'i përkasë Nuses së Krishtit, ne akuzohemi për ekskluzivitet dhe sektarizëm.

Si flasim ne për rikthimin e Zotit?

Këto rrëthana nuk duhet të na dekurajojnë nga përbushja e misionit tonë për të shpallur ardhjen e afërt të Zotit. Por, për t'u kuptuar, ne duhet të veprojmë si Apostuli Pal, i cili u përshtatej dëgjuesve të tij (1. Korint 9,20–23). Predikimi ynë i sotëm rrëth Ardhjes përsëri të Zotit, duhet të përfshijë aspektet e mëposhtme:

Si ringjallja dhe ngjitja e Jezu Krishtit në qzell, ashtu edhe kthimi i tij, është i imagjinueshëm vetëm përmes besimit. Zoti ka deklaruar se nuk është e mundur të përcaktohet momenti i kthimit të Tij (Mateu 24,44; Luka 17,20). Ai ua tha shumë qartë apostujve të tij: „Nuk është e përshtatshme që ju të dini kohën ose orën që Ati me fuqinë e Tij ka përcaktuar“ (Vep e apost 1,7). Tek Marku 13 ne gjemë sugjerime të Jezusit mbi ngjarjet që i paraprijnë ardhjes së tij. Do të ketë luftëra, tërmete, zi urie, përndekje, si dhe profetë të rremë që bëjnë shenja dhe mrekulli. Të gjitha këto gjëra kanë ekzistuar në të gjithë shekujt e kaluar. Fakti që këto gjëra shfaqen edhe sot, nuk mund të përcaktohen si dëshmi për ardhjen e afërt të Jezusit. Në rastin më të mirë, mund të konkludojmë se ato nuk mund të pengojnë planin e shpëtimit. Le të shmagim, pra, që të flasim për "shenjat e kohërave" në mënyrë që të bindim besimtarët për kthimin e afërt të Jezusit. Ne besojmë në ardhjen përsëri të Zotit, sepse Jezusi u premtoi atyre dhe Fryma e Shenjtë

i shpall ato tek ne. Ne besojmë se Jezusi do të kthehet së shpejti, sepse apostolati po punon përsëri në tokë pér të na përgatitur pér ardhjen e Tij.

Shpëtimi që na ofron Zoti është më shumë sesa një përmirësim i ekzistencës sonë materiale. Ai dëshiron të na çojë në mbretërinë e tij, ku e keqja dhe të gjitha manifestimet e saj (vuajtja, padrejtësia, gjenjeshta, hipokrizia, urrejtja dhe vdekja) janë të përjashtuara. Zoti dëshiron të na japë jetën e përjetshme, domethënë bashkësinë e përjetshme me veten e tij. Në Atdheun Qiellor (Hebrejnje 11: 14-16), njerëzit do të jetojnë në harmoni me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin. Ata do të formojnë një bashkësi të personave që janë të ndryshëm nga njëri-tjetri dhe megjithatë një - një imazh i Trinitetit Hyjnor. Motivimi ynë nuk është të shpëtojmë botën ose të shpëtojmë nga një katastrofë e afërt. Pér ne, hyrja në mbretërinë e Perëndisë nuk është ikje, por përsosmëri. Shpresojmë të jemi ajo që Zoti na krijoi pér të qenë. Ne nuk e mohojmë se njerëzit që janë të vullnetit të mirë dhe që i bashkojnë përpjekjet e tyre mund të sjellin paqe, drejtësi dhe mirëqenie pér një kohë të caktuar dhe pér një pjesë të caktuar të njerëzimit. Por jemi të bindur që ata nuk mund ta bëjnë këtë pér tëre njerëzimin dhe përgjithmonë. Vetëm Zoti i Plotfuqishëm mund të ndihmojë të gjithë njerëzit e të gjitha kohërave duke ndërhyrë në histori. Mishërimi i Perëndisë në Birin e tij ishte një ndërhyrje kaq e drejtpërdrejtë e Zotit në historinë njerëzore. Ndërhyrjet e ardhshme të drejtpërdrejtë konsistonë në rikthimin e Jezu Krishtit, pastaj në ardhjen e Tij në fuqi dhe lavdi me të parëlindurit, dhe madje edhe më vonë në Gjyqjin e fundit, në gjyqjin përfundimtar. Të gjitha këto ndërhyrje hyjnore nuk arrihen nga mendja njerëzore dhe mund të kuptohen vetëm me besim. Ne nuk e shohim atë si një kërcënim të tmerrshëm, por si një shprehje e dashurisë së Zotit pér njerëzimin

Në kthimin e tij të padukshëm, Zoti do të marrë vetëm të zgjedhurit, të cilët kanë arritur pjekurinë e nevojshme. Perspektiva e këtij gjyqji na bën të vetëdijshëm pér nevojën pér përgatitje serioze. Por kjo nuk ka pse të na trembë. Ne e vendosim të gjithë shpresën tonë në hirin, në mëshirën që Zoti do t'u japë besimtarëve, të cilët vërtet frymëzohen nga dëshira pér t'u bashkuar me Të (1 Pjetri 1,13).

Jezusi do të kthehet pér të marrë bashkësinë e tij nuse dhe do të festojë me të dasmën në qiell. Imazhi i nuses i referohet idesë së një komuniteti dashurie, imazhin e dasmës në idenë themelore të gëzimit dhe ndarjes. Por rrëmbimi i nuses nuk është një përfundim në vetvete. Duhet të konsiderohet si një pjesë së planin të shpëtimit. Ata që i përkasin bashkësisë

nuse janë thirrur të përmbushin një detyrë të veçantë: t'u shpallin Ungjillin në Mbretërinë Mijëvjeçare të Paqes të gjithë njerëzve të të gjitha kohërave. Veprimi i Zotit në fund të fundit synon të lejojë të gjitha qeniet njerëzore të arrijnë jetën e përjetshme, bashkimin e përsosur me Perëndinë dhe me njëri-tjetrin.

Si e mbajmë ne të gjallë premtimin e rikthimit të Jezusit?

Apostujt janë porositur, kanë marrë detyrën të japid vulën e shenjtë me anë të së cilës besimtarët bëhet trashëgimtari i Zotit dhe ta përgatisin atë pér kthimin e Krishtit. Kjo përgatitje kërkon pjesëmarrjen aktive të besimtarit: të gjithë duhet të "punojnë" pér shpëtimin e tyre (Filip 2:12). Kjo është arsyja pse është kaq e rëndësishme pér ne të motivojmë besimtarët të mbajnë zgjuar premtimin e kthimit të Zotit.

Pér t'i inkurajuar ata që të përgatiten në mënyrë aktive pér kthimin e Zotit, ne kemi dy mundësi:

- të shtojnë dashurinë e tyre,
- ta bëjmë kishën një parashijim të mbretërisë së ardhshme.

Të shtojmë dashurinë e besimtarëve

Përmes Vulës së Shenjtë, Zoti i jep njeriut një pjesë në qenien e tij, duke i dhuruar atij dhuratën e dashurisë së tij (Rom 5: 5). Nga kjo dashuri lind dëshira e besimtarit pér t'i përgjigjur asaj dashurie (1 Gjoni 4:19). Ne mund ta shtojmë atë dashuri në zemrën e besimtarit

- duke i treguar atij madhështinë e sakrificës së Jezusit.
- duke i mundësuar atij të fitojë, të ketë pjesë në bollëkun e sakrificës së Krishtit.
- duke shpallur atë trashëgimi, që Zoti mban gati pér të.
- duke bërë të shijojë atë dashuri të Krishtit nëpërmjet kujdesit dhe mirkuptimit tonë.

Një fëmijë i Perëndisë, i cili e njeh me të vërtetë dashurinë e Krishtit, është "rrënjosur" në këtë dashuri, është "i mbushur me plotësinë e Perëndisë" (Efes 3: 17-19). Dëshiron me gjithë zemër të jetë me Jezusin. Kjo dëshirë gjen shprehjen e saj në lutjen e përditshme, "Eja, o Zoti Jezus" (Zbul 22:20). Por ai gjithashtu e tregon veten në përpjekjen e vazhdueshme pér të qenë i bashkuar me Perëndinë sot.

Falë mësimit të apostujve dhe marrjes së denjë të Darkës së Shënjtë, besimtarët mund të rriten në Krishtin. Dashuria

e Krishtit u mundëson atyre të kapërcejnë egoizmin dhe indiferencën dhe të hapin veten ndaj të tjerëve: Ata

- interesohen për gjendjen e tjetrit dhe kujdesen per të.
- përpiken të influencojnë nëpërmjet dëshmisë së tyre me fjalë e me vepra, me qëllim që edhe tjetri të mund ta zbulojë, të njohë Krishtin.
- dëshirojnë, që Ungjilli të mund t'ju predikohet të gjithë njerëzve – prandaj i luten Zotit pér të çuar edhe më tutje planin e tij pér shpëtim, duke dërguar Birin e tij pér të vendosur, pér të ngritur mbretërinë e paqes.
- përgatiten në mënyrë aktive pér t'u bërë priftërinj të Zotit dhe të Krishtit në këtë mbretëri të paqes, me qëllim që t'u shpallin të gjithëve shpëtimin

Kisha, paraprijëse e mbretërisë që po vjen

Kur Farisejtë e pyetën Jezusin, kur do të vinte mbretëria e tij, ai u përgjigji se ajo ishte midis dhe brenda tyre (Luka 17,20,21). Me të vërtetë që ajo mbretëri qe prezente në personin e tij; ata, të cilët besonin në të, mundën ta pérjetonin mbretërinë e Perëndisë që në tokë.

Në ditët tona Jezusi është prezent në Kishën e tij nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë. Në mesin e tyre ai vepron në fjalë dhe në shenjtërimë dhe e drejton atë nëpërmjet apostujve. Aty ku Shpirti i Shenjtë vepron nëpërmjet Jezu Krishtit pér këtë post të rëndësishëm, besimtarët, gjatë marrjes së Darkës së Shenjtë, pérjetojnë një lidhje të ngushtë me të dhe me njëritjetrin. Në këtë mënyrë ata mund të shijojnë qysh këtu në tokë shpëtimin që do të fitojnë në mbretërinë e Perëndisë që do të vijë.

Besimtari, i cili duket i kënaqur në pritje pér ardhjen përsëri të Zotit, duke u lutur dhe duke marrë pjesë në shërbesa fetare, përfundimisht do të lodhet duke pritur. Nëse, nga ana tjetër, ai mund të shijojë gjëzimet e mbretërisë së ardhshme pérpara, ai do të jetë më i motivuar të dëshirojë të hyjë atje. Me fuqinë e Frymës së Shenjtë, ne punojmë pér ta bërë kishën një paraprijëse të mbretërisë së ardhshme të Perëndisë! Qëllimi ynë është të bëjmë të mundur që të gjithë të pranojnë se Jezusi sundon në kishën e tij. Prania e Jezu Krishtit njihet nga shenjat e mëposhtme:




Photo: © sewcream - stock.adobe.com

- Do të shërohen të verbërit, ata që nuk dëgjojnë e që nuk flasin – me ndihmën e Zotit ne mund të kapërcejjmë gjithshka, që vështirëson apo pengon komunikimin dhe lidhjen tonë tonë me të tjerët.
- Akuzuesit heshtin (Jeremja 8, 9), ata nuk po flasin më pér gabimet që Jezusi fal.
- Diskutimet se kush është më i madhi ndër ta shuhen, përfundojnë; secili është i gatshëm pér t'i shërbyer tjetrit (Marku 9,34,35).
- Dallimet njerëzore zvogëlohen në favor të unititetit në Krishtin (Galat 3:28).
- Shqetësimi pér kujdes shpirtëror nuk shtypet më nga gjërat materiale (Marku 8: 14-18).

Masthead

Publikuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zürich/Zvicer
Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany
Editor: Peter Johanning



Mjete pune

Pashaportat e udhëtitimit



Pashaportat e hyrjes

| Përjetime

Mesnata kishte kaluar, ishte data 30 maj dhe të rinjt nga Shqipëria prisin në aeroportin e Rinasit avionin e tyre të parë për këtë udhëtim drejt Düsseldorf-it për tu bëre pjesë e Ditës Internacionale të Rinis. Përgatitjet për këtë ditë kishin filluar kohë më parë.

Emocionet dhe dëshira për të qënë në mesin e të rinxve nga e gjithë botë ishte e madhe. Pritja ne aeroport i bënin emocionet më të forta.

Sapo ora shkoj katër e mëngjesit avioni, me të cilin të rinjt nga Shqiperia do të shkonin së pari në aeroportin e Vienës ishte gati për fluturimin e rradhes.

Avioni u nis. Çdo gjë shkoj për mrekulli. Kalimi transit nga Viena nuk ishte lodhje aspak, veç se një kënaqësi tjetër. Pritja ishte më e shkurtër se ajo që ne prisnim dhe dëshira për t'u bërë pjesë e një evenimenti kaq të madh shtohej. Askush nuk e dinte se çfarë do na priste në Düsseldorf por ajo ngjarje që pérjetuan ishte vërtet e paharrueshme. Morëm avionin për në Düsseldorf dhe 1 orë fluturim kaloi vërtet shpejt. Para se t'i drejtoheshim vendit ku shumë të rinj ishin mbledhur pak para nesh, secili prej nesh u pajis me një bezhë e cila do të na identifikonte mes të gjithëve.

I gjithë Düsseldorf ishte përgatitur për këtë ngjarje të rëndësishme. Kudo shihje flamunj me stemen e kishës sonë dhe me moton HERE I AM.

Vendi ku ne do të qëndronim nuk ishtë shumë larg aeroportit të Düsseldorf-it. Messe Düsseldorf ishte vendi ku ne do të qëndronim për 4 ditë.


Ditën e parë, kur ne sapo mbërritëm, moti nuk ishte shumë i mirë. Ishte më ftohtë se në Shqiperi por moti nuk u bë aspak pengesë për këta të rinj. Pasi na treguan vendin ku ne do flinim, ne u pajisëm mjetet e nevojshme për të fjetur 3 ditë. Udhëtimi ishte vërtet i bukur por edhe i lodhshëm. Të rinjt tanë u qetësuan dhe më pas iu drejtuant mensës ku i priste një drek e mirë. Rradha ishte e gjatë, por ishte kënaqësi të prisje në rradhë ku edhe njihej me të rinj të tjerë anë e mban botës.

Pas drekës moti ishte më i mirë dhe dielli dukej sikur të mbushte me energji. Të gjithë iu drejtuam godines numër 6, në të cilën po bëheshin përgatitjet për të nesërmën e cila ishte dita kur cdo shtet do të përfaqesonte veten si edhe ne. Ne shfaqëm për vendin tonë kostume tradicional shqipare dhe punime me dorë.




Të rintjtë nga Lushnja

Pamje nga ekspozita Düsseldorf



Salla 6 e ekspozitës

Salla e ngrënies dhe fjetjes



Dita e parë iku shumë shpej dhe një ditë edhe më e bukur na priste. Zgjoheshim herët për të mos humbur asnjë minut më shumë. Sërisht i drejtoheshim mencës për një mëngjes të bollshëm dhe të shëndetshëm. Ishte bukur kur uleshim dhe hanim mëngjesin të gjithë sëbashku plot hare.

Dita e dytë ishte dita e hapjes së panairit. Panairi ishte mrekulli tjetër. Ishte e pa besueshme te shikoje kultura nga e gjithë bota brenda një ndërtese të vetme.

Ishte kënaqësi të mësoje dhe të bëheshe pjese e kulturave dhe traditave të ndryshme. Panairi qëndroi i hapur për 3 ditë. Çdokush mund të behej pjes e panairit i cili hapej

shpej në mëngjes dhe qëndronte i hapur deri ne ore te vona të natës. Atje gjeje edhe aktivitete të panumërtë. Pasditen e asaj dite te premteje na priste një koncert madheshtor ne stadiumin e qytetit Merkur Spiel-Arena. Të rintj ishin të ndare ne rruge sipas 4 ngjyrave blu, e kuqe, e verdhe dhe e gjelbërt në të cilën ishim pjese edhe ne. Rruga e gjelbërt ishte rruga me e gjate për të mbërritur ne stadium por me siguri edhe me e bukura.

Para se te shkonim ne stadium u veshem kuq e zi me flamunj në duar. Sapo mberritem ne stadiuim secili prej nesh mori një drite e cila ishte me auto-komand.



Veshje tradicionale



Te rinj shqiptarë me flamuj në duar

Stadiumi i madh, Arena.



Foto: Jessika Krämer

Atmosfera në ate stadium ishte e magjishme. Nuk ka fjale ta pershkruaj ate ndjesi, ku per te rinjt organizuar një koncert me permasat e një koncerti mëse të madh.

Koncerti mbaroj rreth ores 12pm dhe te gjithe u nisen drejt vendit kur qendronim per te marr një pushim te vogel ose per te ngrene dicka sepse magjia nuk kishte mbaruar akoma. Rreth ores 17pm u nisem serisht drejt stadiumit. Kete here një film i nderthurur me modernen dhe shkrimin e shenjt solli shkrimet e shenjta ne aktrim, me kenge moderne dhe kercime qe e benin performancen plotesisht madheshtore.

Rreth ores 10:20 pm edhe koncerti mbaroj. U nisem serisht drejt vendit ku qendronim. Edhe dita e dyte ne Diten Internationale e te Rinis mbaroj me mbresat me te mira. Diten e trete takuam te rinjt te cilet bene te mundur ardhejnj tone ne kete eveniment . Falenderimet tona jane te pafundme dhe te sinqerta. Me te keta te rinj krijuam edhe mardhenje shoqerore te ngushte , qe shpresojem ta ruajme per gjithmon. Dhe i dergoj te fala te perzemerta Melanis dhe Valentines .

Pas ketij takimi te rinjt shqiptar iu drejtuan qytetit te

Düsseldorf-it per një udhetim ne qytetin e vjetër te Düsseldorf-it.

Udhetimi ne qytetin e vjetër ishte i mahnithsem. Pas ketij udhetimi te bukur dhe te gjate ne qytet u rikthyem ne Messe Düsseldorf ku aktivitetet nuk kishin te mbaruar por ditet iken shume shpejt kur kalon kohe te bukur me njerez te mire. Dita e diel erdhi shume shpejt, gezimi kishte pushtuat zemrat tona, sherbesa e te dieles do te fillonte paspak po ne stadiumin e dites me pare. Sherbesa fetare zgjati rreth 3 ore te cilat ngjasuan si 3 minuta. Morem bekimet e Apostulit Kryesor dhe me pas morem rrugen per ne shtepin tone.

Kjo ngjarje ka lëne mbresa në mendjet tona dhe është e pamundur mos ta kujtosh ne çdo moment.



Te rinj nga Shqipëria dhe Krefeld-i

Zoti te Mrekullon me prezencen e tij!

Ishte nje e dielë e bekuar! Rruga per ne Elbasan më kënaq! Elbasani me historinë e tij arkeologjike dhe historike të magjepste, pasi shikoje burime, shtëpi, kala, monumente dhe mure shekulllore. Kisha jonë ishte një shtëpi e ulët shumë e bukur, kopshti përreth i lulëzuar, pemët portokall, mandarin, limon, shegë, madje të gjitha këto rrethuar nga një mur monument kulture. Sodita të gjithë kishën, kjo, pas provave, pasi edhe pse nuk l përkas më grupit të të rinjve, unë bëja pjesë në grupin e këngëtareve te Tiranës, që në shenjë falenderimi për Apostulin Otten, kishim dëshirë të këndonim këngën himn të të gjithë të rinjve pjesëmarrës në Ditën e rinisë Internacionale në Düsseldorf.

Apostuli Otten mbërriti dhe të rinjte iu afroan ta falenderonin dhe t'i jepnin përshtypjet e atij evenimenti aq mbreslënës. Apstulit, te cilit shkelqimi i fytyrës i pasqyronte shpirtin, dëgjonte dhe gëzohej me të rinjtë. Në fakt, është impresionues fakti, që butësia dhe dashamirësia e tij, vepronin aq natyrshëm në këtë komunikim shpirtëror. Ora e fillimit të shërbesës fetare po afronte. Njerëzit përshëndetin njëri-tjetrin të gëzuar. Ishte një shërbësë ndryshe, unë do thoja falenderuese, ndaj Perendisë që zgjedh njerëz të mbrekullueshëm që ndikojne aq gëzueshëm në jetën e tjeterit. Epo le ta them që Apostuli Otten e bënte këtë ndikim të mirësisë së Zotit, pasi ishte i gëzuar në shpir. Ishte i emocionuar! Apostuli Otten kishte përgatitur një predikim mbi fuqitë dhe dobësitetë e Mbretit David. Në fakt, e shijova si ushqim atë predikim dhe nuk harroj të shpreh atë që tha Apostuli: "Davidi kishte zell për te vepruar, ai e dinte që Zoti ishte me atë, por u ul ama i mori 5 gurë, në tokë. Ai

ishte i zellshem të bënte gjithçka me Zotin që na forcon". Predikim që më kumbon akoma në mendje.

Anëtarët e kishës me pas u gëzuan me këngen e përgatitur posaçërisht për të falenderuar Apostulin Otten. Kënga titullohej "HERE I AM". Po, ne e kënduam dhe ajo na emcionoi të gjithëve pasi shpreh fuqinë dhe hirin e Zotit të derdhur tek ne. Apostuli Otten me të vërtetë që u kënaq shumë saqë na kërkoi të mund të përsëritnim edhe njëhere strofën e dytë, e cila shprehte aq bukur lidhjen tonë shpirtërore me Perëndine tonë te plotfuqishëm. Sytë blu të Apostulit Otten u perlotën, nuk mund ta harroj këtë. Ai na shihte i emocionuar dhe në fakt, Fryma e të Shenjtit, kishte prekur zemrat tona nepërmjet predikimit te tij dhe këngës tonë. Ajo mbasditë mbeti e paharuar në mendjen time dhe me mirënjohje faladeroj Apostulin Otten që me dashamirësi dhe kenaqësi vleresoi emocionalisht fuqishëm, këngën tonë.

Faleminderit I them Zotit për këtë përjetim!



Pasqyra

- 06.10.2019 St. Petersburg (Rusi)
- 13.10.2019 Monrovia (Liberi)
- 20.10.2019 Mülhausen (Francë)
- 27.10.2019 Kuala Lumpur (Malajzi)
- 30.10.2019 Kalay (Myanmar)
- 03.11.2019 Yangon (Myanmar)
- 10.11.2019 Norderstedt (Gjermani)
- 17.11.2019 St. Gallen (Zvicër)
- 01.12.2019 Malaga (Spanjë)
- 08.12.2019 Ludwigsburg (Gjermani)
- 13.12.2019 Walfischbucht (Namibi)
- 15.12.2019 East London (Afrika e Jugut)
- 22.12.2019 Hersfeld-Lauterbach (Gjermani)
- 29.12.2019 Stade (Gjermani)

New Apostolic Church
International

